

Informatë për prindërit

Lokacioni

AUK ndodhet në Prishtinë, në kryeqytetin e Kosovës, që poashtu është qendra më e rëndësishme ekonomike në vend. Me lokacionin afër Gërmisë, parkut më të madh në qytet, iu ofron studentëve një ambient të shkëlqyeshëm natyror.

Akreditimi dhe Diploma

AUK ka partneritet me Institutin e Rochesterit për Teknologji (RIT), një ndër 10 universitetet më të mëdha private në SHBA, që ka afërsisht 16.000 studentë. Studentët e AUK janë pjesë e RIT dhe studimet e tyre bazohen në programet akademike të RIT. Në fund të studimeve të tyre, studentët tanë marrin diplomë nga RIT. Diplomë kjo e njohur ndërkombëtarisht.

Kurrikula dhe Mësimdhënësit

AUK ofron studimet "Bachelor of Science" dhe "Master of Science", të cilat janë të bazuara në programet akademike të RIT. Studentët nuk janë të detyruar të vendosin për drejtimin e studimit të tyre në DY VITET E PARA të studimeve. Gjatë këtyre dy viteve, ata janë të obliguar t'i marrin lëndët e përgjithshme, në mënyrë që ta ndërtojnë një bazë të fortë të arsimimit.

Në vitin e tretë, studentët kanë një larmi programesh, për zgjedhjen e drejtimit të tyre. Drejtimet e ofruara në AUK janë: Menaxhim, Ekonomi dhe Statistikë, Politika Publike, si dhe Media dhe Komunikim Grafik.

Profesorët e AUK përmbushin standarde të larta profesionale. Secili prej tyre ka minimum diplomë Master dhe në shumë raste Doktoraturë në fushat e tyre përkatëse. Mësimdhënësit e AUK duhet të jenë aprovuar nga RIT për të ligjëruar.

Kursi Përgatitor

Studentët, të cilët aplikojnë në AUK, e që nuk arrijnë rezultate të mjaftueshme në TOEFL dhe Test të Matematikës, mund ta marrin Kursin Përgatitor. Ky kurs organizohet disa herë gjatë vitit akademik. Të gjitha kurset përgatitore janë intensive dhe zgjasin 7-8 javë, me gjithsej 96 orë. Të gjithë studentët e regjistruar në kurset përgatitore marrin mësim për Gjuhë Angleze dhe Matematikë.

Kriteri i Regjistrimit dhe Afatet e Pranimit

Testet për regjistrim që pranohen në AUK janë:

- 1) Testi SAT ose ACT,
- 2) Rezultati IBT ose PBT TOEFL, dhe
- 3) Testi i Matematikës.

Ekzistojnë tri mundësi ose kushte të regjistrimit në AUK:

1. Regjistrimi i rregullt -pikët e **Testit Pranues** duhet të jenë:
 - a. IBT (Internet Based TOEFL) - 79 pikë e me tepër,
 - b. PBT "Paper Based TOEFL" - 550 pikë, si dhe
 - c. Matematikë - 65 pikë.
2. Regjistrimi me kusht "Conditional":
 - a. IBT- 68 pikë e me tepër,
 - b. PBT "Paper Based TOEFL" - 520 pikë, dhe
 - c. Matematikë - 30 pikë.

Këta studentë marrin lëndë shtesë në gjuhë angleze dhe në matematikë.

3. Regjistrimi në "Foundation Year":

- a. IBT - 52 pikë,
- b. PBT - 460 pikë, dhe
- c. Matemaikë - 15 pikë.

Bazuar në rezultat, këta studentë do të kenë 3-9 muaj kurse në gjuhën angleze dhe në matematikë.

4. Pas regjistrimit, studentët janë të obliguar të dëshmojnë se e kanë përfunduar shkollën e mesme (diploma), dy referenca (letra rekomandimi) nga profesorët e

tyre, si dhe 400 euro pagesë për rezervim të vendit. Çdo vit akademik ka gjashtë afate të regjistrimit. Këto afate mbahen nga Nëntori deri në Korrik.

Për data më të sakta, ju lutem klikoni në linkun më poshtë: <http://www.aukonline.org/recruitment.php>. AUK i inkurajon të gjithë kandidatët, që të regjistrohen sa më parë, për arsye të vendeve të kufizuara dhe të bursave të hapura, bazuar në rezultatin e testit. Afati për dërgimin e aplikacionit - së paku 10 ditë para Provimit Pranues.

Bursat dhe Ndhma Financiare

Jemi të vetëdijshëm se çmimi për arsimim në AUK është i lartë, për shumë familje në Kosovë dhe në regjion. Për këtë arsye, ofrojmë Bursa dhe Ndhmë Financiare për studentët. Është një numër i konsiderueshëm i bursave, bazuar në meritat personale, ndihmë financiare sipas nevojës, punë dhe studim (work and study), që ofrojnë punë për studentët në AUK. Për më tepër informata të bursave dhe ndihmës financiare shikoni linkun "Financial Aid" në web-faqen tonë.

Pas AUK

Si pjesë e programit akademik në AUK është po ashtu Edukimi Bashkëpunues (Co-op), i cili i obligon studentët të punojnë gjatë studimeve të tyre. Çdo student është i obliguar t'i përfundojë së paku dy punë praktike, në mënyrë që t'i plotësojë 800 orë punë. Angazhimi i studentëve në punë praktike ka treguar mjaft sukses, duke u ndihmuar atyre të gjejnë punë dhe ta zhvillojnë karrierën e tyre. Si rezultat i kësaj dhe i arsimimit të tyre të shkëlqyer, mbi 93% të studentëve nga AUK - janë të punësuar. Studentët tanë janë punësuar në kompanitë më të mira private në Kosovë dhe në regjion, e po ashtu, edhe në institucione qeveritare. Shumica prej tyre janë të punësuar në banka të ndryshme si: Pro Credit Bank, Raiffeisen Bank e TEB, si dhe në kompani të tjera të suksesshme si: Dukagjini, Elkos, Mabetex etj. Të tjerët kanë vazhduar studimet e tyre në universitete prestigjioze në SHBA dhe në Evropë.